

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

I	Data	05.03/20	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri		Shtojcë
01 N1. 60/01- 5392/20				

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së II-të (Dytë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 28 Shkurt 2020.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e II-të (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 28 Shkurt 2020, dhe atë:

1. Rregullorja për Taksat Komunale/ Lënda: 01Nr. 60/01-4863/20;
2. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019 / Lënda: 060/01-5004/20;
3. Vendimi për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 Lënda: 01Nr.60/01-5452/20; dhe
4. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 60/01-368/19 – për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfytëzim të pronave të paluajtshme të komunës / Lënda: 01Nr.104/02-3037/20.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Makfire Malsiu

From: Gëzim Sahiti
Sent: Monday, March 16, 2020 10:50 AM
To: Nazmi Jashari; Hasan Gjyrevci; Makfire Malsiu; Idajet Rexhepi; Idajet Rexhepi
Cc: Safet Kamberi; Kemajl Murseli; Vjollca Konjusha; Medina Brahaj

Të nderuar/a

Marre parasysh gjendjen e krijuar me shfaqjen e pandemisë së Corona Virusi Covid-19, ju njoftojmë se vlerësimet e ligjshmërisë së akteve të dërguara ne MAPL pas miratimit nga kuvendet e komunave tuaja nga data 24.02.2020, deri me tani, shtyhen për vlerësim marre parasysh kufizimeve ne vendin e punës andaj ju lutem qe publikimin dhe zbatimin e tyre të mos e filloni deri në njoftimin nga MAPL, kjo sidomos ka të bëjë me rregulloret komunale për tarifa gjoba komunale si dhe aktet të cilat vlerësohen nga Ministritë e linjës.

Ne fund shpresoj te jeni mire dhe të kalojmë me shëndet të plotë këtë pandemi të Corona Virusi Covid-19.

Me respekt!

Gëzim Sahiti
Zyrtar i lartë për Monitorim të Komunave
Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
☎ 038/200-35-574 Mob. +383 44 393-313
✉ gëzim.sahiti@rks-gov.net
Adresa: Ndërtesa e Qeverisë (ish-Rilindja), kati XI zyra Nr.1117

Makfire Malsiu

From: Gëzim Sahiti
Sent: Tuesday, May 19, 2020 12:55 PM
To: Makfire Malsiu
Subject: Re:

Sa i perket rregullores para muajit qershore nuk mund bejmi asgje pasi qe varet nga ministrite tjera dhe ende zyrtaret nuk jane kthyer ne pune...

Sent from my Samsung Galaxy smartphone.

----- Original message -----

From: Makfire Malsiu <Makfire.Malsiu@rks-gov.net>
Date: 19/05/2020 10:39 (GMT+01:00)
To: Gëzim Sahiti <Gzim.Sahiti@rks-gov.net>
Subject:

Përsëndetje Gëzim,

Besoj se jeni mirë dhe mirë po kaloni,

Me intereson të di nëse ka ndonjë konfirmim lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të KK të datës 28 Shkurt 2020

të cilat janë pezulluar shqyrtimi i ligjshmërisë së tyre për shkak të pandemisë Covid-19.

Në ato akte është edhe Rregullorja e taksave Komunale., për të cilin akt po kemi kërkesa të vazhdueshme nga zyrtarët komunal për hyrjen në fuqi të saj.

Respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 060/01-5004/20
Kaçanik: 28.02.2020

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28 Shkurt 2020, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR POLITIKË
DHE FINANCA PËR VITIN 2019

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 060/01-5004/20 - me tekstin e mëtejshëm "Raport Pune i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019".
2. Raporti si në pikën 1 të këtij Vendimi përmban, pikësynimet në lidhje me realizimin e detyrave nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe nivelin e realizimit të tyre lidhur me aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2019.
3. Raporti është përmbledhur në gjithsej 10 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Kaçanik
Skupština Opština
Municipal Assembly
- Komiteti për Politikë dhe Financa-

01Nr. 60/01-5004 /2020
Kaçanik, 19.02.2020

**RAPORT PUNE
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA,
PËR VITIN 2019**

Kaçanik, Shkurt 2020

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	2
1. HYRJE.....	3
2. QËLLIMI.....	3
3. PËRGJEGJËSITË E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA.....	3
4. AKTIVITETI I KPF.....	3-4
5. ÇËSHTJET E SHQYRTUARA.....	4-5
5. PROPOZIM RREGULLORET.....	5
7. KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2020-2022.....	5
8. PROJEKTBUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN FISKAL 2020 DHE KËRKESAT E PROJEKTUARA PËR VITETI 2021-2022.....	5-6
9. RAPORTET FINANCIARE	6-7
10. PROPOZIM VENDIMET PËR ÇËSHTJE FINANCIARE.....	7
11. PROPOZIM VENDIMET TJERA MË RËNDËSI PËR KOMUNËN.....	8
12. VENDIMET	8-9
13. PLANET E PUNËS DHE RAPORTET E PUNËS.....	9
14. ÇËSHTJET TJERA MË RËNDËSI PËR KOMUNËN.....	9-10
15. SHËRBIMI I KUVENDIT.....	10
16. PËRFUNDIM.....	10

Lista e Shkurtesave

KPF- Komiteti për Politikë dhe Financa
KK- Kuvendi i Komunës
LVL- Ligji për Vetëqeverisjes Lokale
OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
OJQ- Organizata Joqeveritare
IT-Teknologji Informativë
KAB- Korniza Afatmesme Buxhetore
QB- Qarkore Buxhetore
DBZHRP -Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
SHIL-Shoqata e Invalidëve të Luftës
DAK-Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
DEFZH- Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit
PFV- Përfundimin e Vitit Fiskal

Hyrje

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) si trup i përhershëm punues i Kuvendit të Komunës, është formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës 01Nr.60/01-1946/18 më datë: 24.01.2018, në përbërje prej 7 anëtarëve.

Në vitin 2019 KPF ka funksionuar me këtë përbërje:

- | | |
|------------------|-------------------------------------|
| 1.Kemal Mërseli | nga PDK, Kryesues sipas funksionit, |
| 2.Nexhat Loku, | nga PDK, anëtar, |
| 3.Pranvera Loku | nga PDK, anëtare, |
| 4.Ekrem Kyçyku | nga LVV anëtar, |
| 5.Selim Reka | nga LDK anëtar, |
| 6.Albana Troni | nga AAK anëtare, dhe |
| 7.Hafize Sallahi | nga NISMA anëtare. |

Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, reflekton përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e Komunës. Me Komitetin për Politikë dhe Financa, udhëheq Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kemal Mërseli, sipas funksionit që e ka. Mandati i KPF-së është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

Qëllimi

Pasqyrimi i të gjitha aktiviteteve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për gjatë vitit 2019, në suaza të përgjegjësive të përcaktuara në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe akteve nënligjore dhe raportimi i këtyre aktiviteteve tek organi themelues, Kuvendi i Komunës.

Përgjegjësitë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Sipas nenit 52.2 të Ligjit Nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisje Lokale, KPF-a është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesëm, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore të tarifave dhe ngarkesave, planin vjetor të punës së auditimit të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit të komunës gjatë vitit fiskal si dhe marrjen e raporteve nga kryetari i komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

Aktiviteti i KPF-së

Sipas Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, si dhe kompetencave të bartura nga Kuvendi i Komunës (kompetencës për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore) KPF-a për gjatë periudhës raportuese është munduar që në suaza të kompetencave të veta t'i realizoj detyrat të cilat janë parashtruar.

Veprimtarinë e vet e ka orientuar në fusha të ndryshme të cilat me legjislacionin në fuqi i janë lënë në kompetencë. Aktiviteti i Komitetit për Politikë dhe Financa është zhvilluar në takime të rregullta mujore. Gjatë periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kanë qenë të suksesshme dhe konstruktive. Angazhimi i anëtarëve të KPF-a ka qenë në nivel të duhur. Prezenca e anëtarëve të këtij komiteti ka qenë e rregullt. Në mbledhjet e KPF-së ka mbretëruar një frymë e punës dhe e

bashkëpunimit në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë komitet. Çështjet që kanë qenë në interes të përgjithshëm të komunës, kryesisht janë aprovuar njëzëri. Për të gjitha mbledhjet e KPF-a është mbajtur Procesverbal i cili ruhet me pedanteri dhe është transparent në çdo kohë. Në takimet e KPF-së janë shqyrtuar çështje të ndryshme në interes të komunës. Për disa çështje të caktuara në këtë komitet janë marrë edhe vendime adekuate apo iu kanë rekomanduar organit vendimmarrës- Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendosje apo sa për njoftim. Për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatoj Kuvendi i Komunës në seancën e vet, kjo trupë punuese paraprakisht i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet. Në këtë drejtim ka vënë në shqyrtim 96 pikë prej të cilave një pjesë të vogël të tyre (13) i ka vendosur sipas kompetencave të bartura të KK, ndërkaq 71 çështje që janë në kompetencë të KK, e ka dhënë mendimin e vet dhe të njëjtat ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim apo marrjen e vendimit adekuat.

Duke marrë parasysh natyrën e çështjeve, ka marrë Vendime për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për të cilat paraprakisht ka kërkuar mendimin profesional të drejtorisë përkatëse. Po ashtu në çdo mbledhje të KPF-së është aprovuar Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF-së. Vlen për t'u theksuar se për çdo çështje që ka aprovuar ky komitet, është hartuar akti konform Vendimit të KPF-së.

Në takimet e kësaj trupe punuese kanë marrë pjesë, Kryetari i Komunës apo Nënkryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive Komunale, të cilët i kanë arsyetuar çështjet e propozuara sipas fushë veprimtarisë së tyre. Ekzekutivi i komunës në mbledhjet e KPF-a ka dhënë edhe Informacione tjera të nevojshme shtesë aty për aty, apo në mbledhjen vijuese në formë të shkruar për çështje të ndryshme dhe sipas kërkesave të KPF-a.

Bashkëpunimi i KPF-a me stafin ndërkombëtarë gjatë periudhës raportuese ka qenë në nivelin e duhur. Materiali i mbledhjes i është dërguar OSBE, të cilët kryesisht i kanë monitoruar mbledhjet. Gjithashtu materiali i mbledhjes i është dërguar edhe OJQ-ve Mbledhjet e KPF-së janë mbajtur me dyer të hapura për çdo të interesuar për me i përcjellë mbledhjet. Punën e kësaj trupe punuese e ka përcjellë kryesisht zyrtari për Informim, dhe për aktivitetin e zhvilluar të KPF-a ka bërë një përmbledhje të punimeve të mbledhjes dhe të njëjtin e ka plasuar në faqen zyrtare të komunës. Ftesa për mbledhje është publikuar çdo herë në faqen zyrtare dhe në tabelë të shpalljeve. Kjo tregon sesa ka qenë transparente kjo trupë punuese ndaj qytetarëve të komunës, mediave, OJQ, etj. për takimet e KPF dhe aktivitetin tjetër të saj të zhvilluar përgjatë periudhës raportuese. Nga Zyra e IT-së është krijuar linku për publikimin e Ekstraktit të mbledhjes së KPF. Në këtë link është publikuar Procesverbali i mbledhjes se 12 të KPF i vitit 2019, ndërkaq do të vazhdohet me publikime tjera të aktivitetit të kësaj trupe punuese.

Çështjet e shqyrtuara

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë periudhës raportuese i ka shqyrtuar gjithsej, 96 pikë përfshirë Procesverbalin e mbledhjes së KPF, i cili ka qenë pikë e parë e rendit të punës në çdo mbledhje. Çështjet e shqyrtuara janë materiale të përgatitura nga shërbimet përkatëse profesionale të komunës. Propozim Vendimet kanë qenë të natyrave të ndryshme. Në kuadër të propozim Vendimeve janë shqyrtuar çështje të cilat kanë të bëjnë me rregullativen normative, çështje buxhetore, raporte dhe programe të punës së ekzekutivit të komunës, propozim vendime të ndryshme të shërbimeve përkatëse profesionale, dhe çështje tjera më rëndësi për komunën. Në vazhdim do të i potencojmë çështjet të cilat kanë qenë në shqyrtim të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Propozim Rregulloret

Në kuadër të kësaj sfere bëjnë pjesë aktet normative të cilat kanë qenë në shqyrtim të kësaj trupe punuese. Në këtë drejtim ky Komitet ka shqyrtuar akte normative të propozuara nga shërbimet përkatëse profesionale, dhe atë:

Propozim Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Kaçanikut;

Propozim Rregullore për Mbrojtjen e Drejtave të Fëmijëve ;

Propozim Rregullore për Transparencë Komunale;

Propozim Rregullore për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2020;

Propozim Rregullore për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut. Të Propozim Rregullorja e fundit vlen të theksohet së KPF ka kërkuar nga ekzekutivi i komunës të gjenden forma për kompensimin e administratorëve të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, kur dihet fakti së deri me tani kanë punuar pa kompensim.

KPF i ka shqyrtuar në detaje të gjitha këto propozim aktet normative të sipërshënuara, ka dhënë vërejtjet e saja dhe të njëjtat me Rekomandime të këtij komiteti i janë përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. apo në procedurë të mëtutjeshme-debatit publik me qytetarë të komunës. Kontribut të veçantë në çështjen e rregullativës normative, KPF-a ka dhënë edhe në debate publike të organizuara më qytetarë.

Korniza Afatmesme Buxhetore(KAB) 2020-2022

Si çdo herë kur janë shqyrtuar çështjet buxhetore edhe në vitin 2019, KPF-a i ka kushtuar rëndësi të veçantë; Kornizën afatmesme të shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut për vitet: 2020-2022 dhe Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2020 dhe vlerësimet për vitet 2020-2022. Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument fillestar për hartimin e buxhetit të komunës. Dokumente përcjellëse që i kanë paraprirë hartimit të buxhetit për vitin 2020 janë: Qarkoret e brendshme buxhetore. Vetëm për Draftin kornizë dhe dokumentet tjera përcjellëse KPF-a ka debatuar gjerë e gjatë, e ka dhënë mendimin e vet, ndërkaq Draftin Kornizë ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. Vlen të përmendet së për Qarkoret buxhetore dhe për Draftin kornizë janë mbajtur edhe dëgjime publike me qytetarë, ku pos zyrtarëve të komunës kanë qenë të obliguar të marrin pjesë anëtarët e KPF, të cilët në këtë drejtim e kanë dhënë kontributin e tyre.

Projekt Buxheti i Komunës për vitin fiskal 2020 dhe kërkesat e projektuara për vitet, 2021 dhe 2022

Në këtë dokument, KPF-a i ka dhënë propozimet e veta për projektet që duhet të hyjnë në realizim më buxhetin afatmesëm të komunës për vitet: 2020-2022. Në këtë drejtim, KPF e ka aprovuar Buxhetin e Komunës për vitin 2020 në shumë: 9,000.530.00€ €, dhe Projektionet për vitet 2021-2022, në shumat buxhetore: 9,315.958.00 € për vitin 2021 dhe: 9,660.090.00€ € për vitin 2022. Edhe në këtë plan afatmesëm buxhetor, KPF-a i ka futur synimet e veta për secilën veprimtari në pajtim me Statutit të Komunës, dhe çdo herë duke iu dhënë prioritet Listës së Projekteve Kapitale. Në këtë drejtim ka aprovuar një Listë me 60 Projekte Kapitale, duke iu dhënë prioritet atyre projekteve që janë me të nevojshme dhe emergjente për komunitetet në shumën, 5,900.690€. Duke marrë për bazë faktin se më buxhetin e ndarë për projekte kapitale, nuk mund të realizohen të gjitha projektet e aprovuara, sepse disa nga projektet kanë hyrë në

listë vetëm sa për t'u koduar, mirëpo gjithherë është menduar në angazhimin e organeve të komunës, në nivelin qendror dhe më gjerë për gjetjen e donacioneve më qëllim që projektet e aprovuara të realizohen. Kontributin e vet për çështjen e buxhetit të komunës, KPF-a e ka dhënë edhe në debatet e organizuara më qytetarë, ku janë mbajtur 3 dëgjime publike (me datë 10, 11 dhe 12 shtator 2019) për çështje të buxhetit të komunës është organizuar nga kjo trupë punuese, udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Pas vlerësimit të thukët nga KPF-a, Projektbuxheti i Komunës për vitin fiskal 2020 dhe Kërkesat e projektuara për vitin 2021-2022, i është përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Raportet Financiare

Nga Raportet financiare KPF ka shqyrtuar:

- Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018;
- Raportin Financiar të Komunës së Kaçanikut, për periudhën: janar-mars, 2019;
- Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën: janar-qershor, 2019;
- Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën, janar-shtator 2019;
- Raportin e Auditivit të Brendshëm për vitin 2018;
- Raporti Final i Auditivit të Përgjithshëm dhe Plani i Veprimit lidhur me Pasqyrat vjetore financiare, për vitin e përfunduar me 31.12.2018;
- Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për PFV 2018;

Të çështja e raporteve financiare, vlen të përmendet se, KPF-a, në disa sektorë vlerëson se janë përmbushur objektivat në pajtim me planifikimin e të hyrave vetjake komunale, ndërsa në disa sektorë në raport me planifikimin ka qenë më pak i kënaqur dhe këto pakënaqësi kjo trupë punuese i ka shprehur sa herë të ekzekutivi i komunës dhe sugjerimet e KPF-a kanë ndikuar në një angazhim pak më të madh të sektorëve të caktuar që inkasimi i të hyrave vetjake komunale në sektorë të caktuar të shënonëj ngritje. Komiteti për Politikë dhe Financa e vlerëson pozitivisht realizimin e të hyrave vetjake nga Tatimi në Pronë, duke shpresuar që ky aktivitet të vazhdojë edhe tutje. Të taksat për ushtrimin e veprimtarisë, të inspektorati, shihet se gjobat kemi tejkalim të inkasimit, kjo është për t'u përshëndetur. Kur jemi të shpenzimet e realizuara, KPF vlerëson se dinamika e shpenzimeve është e vogël në raport me buxhetin, ndërkaq ulje të realizimit të shpenzimeve kemi të Mallrat dhe Shërbimet, të Investimet Kapitale shihet se kemi një ngritje të vogël të shpenzimeve. Ndërkaq dinamika e realizimit të shpenzimeve nuk ka shkuar në raport me alokimin e mjeteve të shpenzuara. Të shpenzimet komunale nga raporti shihet se kemi ulje të shpenzimeve të mbeturinat dhe të telefonia, ndërkaq ngritje të shpenzimeve kemi të shpenzimet e energjisë elektrike.

Në Raportet financiare, vlen të cekët se KPF-a ka kërkuar sqarime shitesë të shpenzimeve buxhetore në programe të caktuara buxhetore sa herë që janë shqyrtuar raportet financiare aty ku ka pasur paqartësi, ndërsa për çdo shpenzim që ka menduar se është i madh apo më pak i arsyeshëm në raport me nevojat të tjera, ka dhënë vërejtjet e tija, ndërkaq i ka mbështetur rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura si në raportin e vitit 2018, duke shpresuar në zbatimin e tyre apo zvogëlimin e tyre deri në fund të vitit 2019. Kur jemi të raportet e auditimit, KPF ka shqyrtuar për herë të parë Raportin e Auditimit të brendshëm, i ka dhënë vlerësimet e veta lidhur me zbatimin e rekomandimeve si në raportin e auditorit,. Kur jemi të ky raport, KPF ka kërkuar të hartohet Plani i menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit, ndërkaq ka sugjeruar që, Auditori i brendshëm më ndihmuar Kryetarin e Komunës dhe ekzekutivin në përgjithësi për eliminimin e parregullsive, në mënyrë që komunës kur t'i bëhet auditimi i jashtëm, mos më gjetur shumë shkelje.

Vlen të përmendet se KPF-a ka kërkuar informacion për procedurat e udhëhequra të tenderimit, ndërkaq kanë sugjeruar Kryetarit të Komunës që Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse komunale të angazhohen lidhur me projektet për të cilat janë zhvilluar procedurat tenderuese, të realizohen në afatet e përcaktuara kohore, ashtu siç e parasheh Ligji i Prokurimit Publik, në mënyrë që mos të ngelin mjete në suficit buxhetore në suficit.

Propozim Vendimet për çështje financiare

Propozim Vendimeve për çështje financiare, KPF-a iu ka kushtuar një rëndësi e veçantë, në këtë drejtim në pamundësi të realizimit të disa projekteve kapitale apo çështje të tjera, është intervenuar në mjetet që nuk kanë arritur të realizohet sipas Listës së projekteve kapitale nga vitet paraprake, për t'i bartur në ndonjë projekt tjetër kapital. Ndërkaq me qëllim që mos të ngelin mjete buxhetore në suficit, KPF ka aprovuar: Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2019 në kategorinë ekonomike, Paga dhe Mëditje; Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019; Propozim Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019. Propozim Vendimi për harmonizimin e mjeteve buxhetore brenda kategorisë së Pagave dhe Mëditjeve për vitin fiskal 2019. Kur jemi të çështjet financiare, KPF ka shqyrtuar: Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore për realizimin e projektit, Instalimi i rrjetit të ujësjellësit në f. Shtrazë; Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Kur jemi të shpenzimet e varrimit, KPF është i mendimit të mbulohen nga buxheti i komunës të gjitha shërbimet pa përjashtim.

Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve për realizimin e aktiviteteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve ka lejuar mjete buxhetore për realizimin e projekteve të drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Rëndësi e veçantë në shpërndarjen e subvencioneve të DAK iu është dhënë kompensimit të udhëtimeve të nxënësve të shkollave të mesme, ndarjen e bursave, financimin e SHKA, Klubeve Sportive dhe OJQ, krejt këto ndarje me u bërë në bazë të Rregullores për Subvencione dhe Transfere, ndërkaq e ka mbështetur Propozim Vendimin për ndarjen e masën drusore të konfiskuar shkollave të komunës. Kur jemi të konfiskimi i masës drusore, KPF ka shprehur shqetësim për dëmtimin dhe shkatërrimin e pyjeve në masë të madhe, ndërkaq në anën tjetër, masa drusore e konfiskuar është shumë e vogël apo vetëm 95 metër hapësinore(mh).

Për çdo ndryshim buxhetor të propozuar, KPF-a ka kërkuar sqarime të nevojshme nga propozuesi pse ka ardhur deri të ndryshimet buxhetore, e në veçanti ka kërkuar arsye të projektet kapitale që kanë qenë në listë për realizim e nuk janë realizuar në kohën e përcaktuar. Arsyetimet e nevojshme janë dhënë në çdo kohë nga Kryetari i Komunës dhe drejtori i DEFZH për çështjet financiare.

KPF, pos tjerash ka kërkuar në vazhdimësi sqarime të nevojshme nga ekzekutivi i komunës se deri ku kanë arritur realizimi i projekteve që janë në listë për realizim në vitin 2019.

Për të gjitha këto çështje, janë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet nga KPF-a dhe të njëjtat i janë Rekomanduar, Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratimin e tyre.

Propozim Vendimet tjera më rëndësi për komunën

Propozim vendimet e propozuara kryesisht janë të natyrave të ndryshme me rëndësi për komunën. Në këtë drejtim, KPF ka shqyrtuar:

Propozim Vendimi për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut nga Komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale. Propozim Vendimi për Ndryshimin e Statusit aktual të KRU “Bifurkacioni” nga Ndërmarrja publike lokale në Ndërmarrje publike qendrore.

KPF ka aprovuar Kërkesën e DBZHPR për ndryshimin e Kontratës me SHIL lidhur me parkingun e automjeteve dhe drutë e konfiskuara, ndërkaq i ka sugjeruar drejtorisë që në KK kjo çështje të bëhet në formë të Propozim Vendimit.

Kur jemi të emërtimi i rrugëve lokale, KPF iu kanë adresuar kërkesa për rrugët në f. Biçec dhe për ndryshimin e një rruge në Kaçanik. KPF ia rekomanduar KK Propozim vendimin e drejtorisë, pa emërtimin e rrugëve lokale në Biçec.

E një rëndësie të veçantë janë edhe : Propozim Vendimi për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës, parcelat kadastrale; 00174-0 dhe 00175-0, Zona Kadastrale Doganaj, për ndërtimin e shkollës së Re “Ali Asllani” në f. Doganaj; Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për objektet publike komunale të sportit në fshatin Bob. Propozim Vendimi për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë. KPF i ka pasur në rend pune 5 oferta nga komisioni vlerësues për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim.

KPF gjatë vitit 2019 ka shqyrtuar edhe: Propozim për formimin e Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale; Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020; Propozim Vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zhvillimin e procedurave për dhënien e këtyre pronave në shfrytëzim afatgjatë.

Vlen të theksohet së, përmes procedurës së KPF kanë kaluar Njëmbëdhjetë (11) Propozim Vendime Paraprake për nderimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të klasës 1-4; Gjashtë (6) Propozim Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës private me pronë komunale; dhe Pesë (5) Rekomandime të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale.

Për të gjitha Propozim Vendimet –rekomandimet e lartcekura, KPF ka debatuar gjerë e gjatë, ka kërkuar mendimin profesional nga shërbimet përkatëse profesionale, dhe të njëjtat me Rekomandime të KPF iu kanë proceduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Vendimet

Komiteti për Politikë dhe Financa, në kuadër të fushë veprimtarisë së vet –kompetencës së bartur nga KK për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelave kadastrale të klasës së 5 dhe të klasës së 6, ka marrë gjithsej 13 vendime. Vendimet të cilat i ka aprovuar ky komitet janë: Katër (4) Vendime për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore, parcela kadastrale e klasës së 6 (Gjashtë) në emër të vëllezërve; Besim, Blerim, Burim dhe Avdullah (Remzi) Gashi, ZK, Begrancë; Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore, parcela kadastrale e klasës së 5 (Pestë) në emër të Xhili (Metush) Vishi, ZK, Rekë. Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të Parcelës Kadastrale Nr.00173-8, Zona Kadastrale Kaçanik, Livadh i klasës së 5, pronë shoqërore në posedim individual të Alban Fuga; Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 01312-1, Zona Kadastrale,

Kaçanik i Vjetër, Arë e Klasës së 6, pronë private në emër të Avdi Tusha; Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të Parcelave Kadastrale më numrat: 00529-0 dhe 00530-0, Zona Kadastrale Doganaj, me kulturë, livadh i klasës së 5 (pestë) dhe arë e klasës së 6 (gjashtë), pronë private në emër të Rexhep Asaj nga f. Duraj-Gabrricë; Vendimi për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 01346-2 Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës së 5, në emër të Bekim Xhini; Vendimi për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 01364-9, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, Livadh i klasës së 5, në emër të Bajram Elezi; Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020; dhe Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Parcelës kadastrale Nr. 001263-3 Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë bujqësore Arë e klasës së 5, në emër të Besarta Zeneli.

KPF-a sa herë që i adresohen propozim vendime të kësaj natyre, sugjeron ekzekutivit të komunës që të kenë kujdes për mos cenimin e Planit Zhvillimore të Komunës në njërën anë dhe në anën tjetër, sugjeron që të ruhet tokat bujqësore, sepse fondi i tokave bujqësore në komunën e Kaçanikut është shumë i vogël.

Planet dhe Raportet e Punës

Nga Planet dhe Raportet e Punës kjo trupë punuese ka vënë në shqyrtim;

- Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për periudhën, janar-dhjetor, 2018;
- Raporti i Përformances Komunale për vitin 2018;
- Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2018;
- Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019;
- Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2020;
- Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2020;
- Plani i Veprimit për Transparencë, për vitin 2020-2023;-
- Plani Komunal i Veprimit për Eficientë të Energjisë (PKVEE) për 2019-2021;
- Plani i Reagimit Emergjent për Komunën e Kaçanikut;
- Plani Komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022.

Të përformanca e komunës, Komuna e Kaçanikut është ranguar e 15-ta, d.m.th si komunë jemi mbimesataren në aspektin e përformancës, ndërkaq KPF vlerëson që komunës tonë i mbetet obligim që edhe tutje me u angazhua në ata sektorë ku nuk janë përmbushur objektivat, me qëllim përmirësimi dhe për një përformancë me të mirë në vitet tjera. Të Plani për eficientë, KPF sugjeron që të shqyrtohen mundësitë e instalimit të ngrohjes së qytetit të Kaçanikut. Ky projekt i kontribuon në një formë mos-shkatërrimit të pyjeve të komunës tonë. Të Plani i reagimit emergjent, KPF identifikoj objekte tjera që duhet hyjnë në këtë plan dhe objektet që mund të riparohen për t'u përdorur në rast rreziku si dhe nevojën e objekteve ndërtimore me u pajisur më shkallë ndihmëse dhe hidrantë. KPF i ka shqyrtuar në detaje të gjitha raportet dhe planet e punës të theksuara si më lartë, ka dhënë mendimet e veta për objektivat e paraqitura në çdo plan pune, vërejtjet dhe sugjerimet në raporte dhe plane punës dhe të gjitha këto dokumente ia ka përcjellë Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtimit apo të miratimit.

Çështjet të tjera me rëndësi për komunën

Ndër çështjet tjera me rëndësi për komunën, KPF ka vënë në shqyrtim informatat si vijon:

- Informatë e Zyrës së Personelit, për përudhën: Janar-Dhjetor 2018;
- Informatë lidhur me zbatimin e Planit të Integritetit, për vitin 2018; dhe

- Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2018/2019.
